

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË TREGTARE
“PROJECT STAR” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË**

Sot, më datë 26.03.2024(dymijëenjëzeteekater):

- **Dritan MARKU**, shtetas shqiptare, i datëlindjes 10.04.1978, lindur në Mat dhe baues në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër peronal H80410274J, madhorë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Vendosi:

Themelimin e shoqërisë tregtare “**PROJECT STAR**” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqërinë Tregtare “**PROJECT STAR**” SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (në vazhdim Shoqëria). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**PROJECT STAR**” SH.P.K

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar te lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshëm qe mund te kryeje një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here dhe ne veçanti, por pa u kufizuar në;

Shoqëria ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

- Studim, analizë, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaikë, parqet e erës, termocentralet, biomasa etj.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaikë, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovalueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmëse. Kompania përfshihet pa u kushtëzuar në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, nga institucionet përgjegjëse shtetërore



- (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e aktivitetit në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Shitia me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit.

Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mësipërm. Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë cdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtëshme, dhe cdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë. Duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe cdo aktivitet aksesor i lidhur me sa më sipër, si punime gërmimi, punime për prishjen dhe punime të tjera të lidhura me tokën, punime civile, elektrike dhe mekanike të cdo lloji si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import-eksport të pajisjeve, riparim dhe mirëmbajtje të materialeve dhe pajisjeve dhe të gjithë aktivitetet e lidhura me këto cështje, gjithashtu dhe në fushën e aktiviteteve të tregtimit.

Për ushtrim të aktivitetit të shoqërisë me gjithë ndryshimet që mund të ketë shoqëria mund të hyjë më marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunimi me palë të tretë qofshin ente publike apo private, të marrë pjesë në procedura të ndryshme konkurrimi në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Të gjitha veprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkesave të ligjit të fushës

NENI 4

Selia e Shoqërisë


Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, “Long Hill Residence”, ZK.2735, Psuria Nr. 53/83, Petrelë, Tiranë.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën prej 100,000 (njëqindmijë) lek.

Ortakët themelues të Shoqërisë zotërojnë kuotat si më poshtë:



- **Dritan MARKU** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 100,000 (njëqindmijë) lek.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ta.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve– organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

- **Administratori i Shoqërisë “Project Star” Sh.p.k, do të jetë Dritan MARKU shtetas shqiptare, i datëlindjes 10.04.1978, lindur në Mat dhe baues në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër peronal H80410274J, madhorë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjtit përkatës dhe statutit.



NENI 9

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë pér dëmet që i janë shkaktuar pér faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët/u themelues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akti i Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKËT THEMELUES

Dritan MARKU

Dritan Marku

